

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PËRMBARIMIT
ZYRA PËRMBARIMORE KURBIN

Nr. 443/Prot.

Laç, me 26.10.2021

V E N D I M - S H P A L L J E

(Lidhur me ekzekutimin e "Urdherit të Ekzekutimit" të titullit ekzekutiv të debitorit)

Ne Lac sot me date 26.10.2021

Une, Rovena Prenga, me detyre Permbarues Gjyqësore pranë Zyres Permbarimore Kurbin, pasi studiova aktet proceduriale të çeshtjes permbarimore Nr.566 rregj. të vitit 2021 bazuar në Urdherin e ekzekutimit Nr.-- prot Dt .21.07.2021 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lezhe,

KONSTATOVA:

Se në datë 16.09.2021 është depozituar pranë Zyres së Permbarimit kërkesa e kreditorit Prokuroria Rr. Gj. Lezhe së bashku me "Urdherin e Ekzekutimit" të Titullit Ekzekutiv vendimin gjyqësor Nr.219 të dt. 16.06.2021 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lezhe, me palë dhe objekt si më poshtë:

-Kreditor: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lezhe.

-Debitor: Ndue Zef Zefi i dtl.10.07.1977 me banim Lgj.5, Laç.

-Me objekt: Pagim shpenzime proceduriale 3.000 leke + 360 leke tarifat fikse permbarimore me TVSh, në total 3.360 leke.

Nga ana e zyrë tone permbarimore kanë filluar procedurat në bazë të nenit 515 e vijues të K.Pr.Civile si dhe ligjit 8730 datë 18/01/2001 "Për Organizimin dhe Funksonimin e Sherbimit Permbarimor Gjyqësor" i ndryshuar për ekzekutimin e detyrueshëm të Titullit Ekzekutiv të sipërcituar.

Nga verifikimi i kryer nga ana jone në bashkëpunim me organet kompetente rezultojnë se debitori Ndue Zef Zefi i dtl.10.07.1977 me banim Lgj.5, Laç nuk ka marrë dijeni nepermjet sherbimit postar, si rezultat i kesaj bazuar në nenin 133/a, 133/b dhe 144/a si dhe 517 të K.Pr.Civile duhet të behet njoftimi me shpallje publike i debitorit lidhur me detyrimin që ai ka ndaj palës kreditore Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lezhe për Ndue Zef Zefi që të paguajë detyrimin shpenzime proceduriale 3.000 leke + 360 leke tarifat fikse permbarimore me TVSh, në total 3.360 leke.

Sa më sipër në mbështetje të Nenit 133/a, 133/b dhe 144/a si dhe 517 të Kodit Procedures Civile, ligjit Nr.8730 datë 18/01/2001 "Për Organizimin dhe Funksonimin e Sherbimit Permbarimor Gjyqësor", i ndryshuar

V E N D O S A

1-Te kryej njoftimin nepermjet shpalljes publike me afat 20 (njetzet) ditor (duke marrë parasysh edhe komunikimin postar) nga data 26/10/2021 - 14/11/2021 të debitorit; Ndue Zef Zefi i dtl.10.07.1977 me banim Lgj.5, Laç.

2-Ky vendim perpilohet në disa kopje, ku një kopje afishohet në vendbanimin e fundit të palës debitore, një kopje afishohet në këndin e njoftimeve të kesaj zyre, një kopje dergohet për afishim në ambjentet e Bashkia Kurbin, një kopje dergohet për afishim në ambjentet e Gjykates së Rrethit Gjyqësor Kurbin dhe një kopje i dergohet për publikim në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Permbarimit Tirane.

3-Kjo shpallje publike ka vlerën e aktit të njoftimit për palën debitore; Ndue Zef Zefi i dtl.10.07.1977 me banim Lgj.5, Laç.

4-Pala debitore Ndue Zef Zefi i dtl.10.07.1977 me banim Lgj.5, Laç, duhet të paraqitet pranë Zyres Permbarimore Kurbin me seli në Lgj nr.4, Lac në katin e parë në ambjentet e Gjykates së Rrethit Gjyqësor Kurbin dhe të marrë kontakt me permbaruesin gjyqësor të çeshtjes permbarimore për t'iu vënë në dispozicion aktet permbarimore, pasi me kalimin e ketij afati do të vijohet me ekzekutimin e detyruar sipas parashikimeve të nenit 519 e në vijim të K.Pr.Civile.

U shpall, sot me datë 26.10.2021.

PERMBARUES GJYQËSOR
ROVENA PRENGA

